



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 166

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 21 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 74/2018, datë 25.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar.....	11251
Dekret i Presidentit nr. 10926, datë 2.11.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11253
Dekret i Presidentit nr. 10953, datë 15.11.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11253
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 14.11.2018	Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Guangzhou, Kinë.....	11253
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 14.11.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Operacionin e Nato-s ‘ <i>Aegean Sea</i> ’, të ndryshuar”	11254
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 14.11.2018	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrit të Mbrojtjes”, të ndryshuar”	11254
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 14.11.2018	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Tiranë, të një pjese të pasurisë së paluajtshme shtetërore, nr. 4/258, të “Alba Film” sh.a., Tiranë.....	11256

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 14.11.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtimin e një kaponi industrial një kat-repart përpunimi, nga ana e shoqërisë “ <i>Laser Tube Albania</i> ” sh.p.k.	11256
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 14.11.2018	Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë.....	11257
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 14.11.2018	Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë.....	11268
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688 , datë 14.11.2018	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të objektit me emërtim “Oborr i Qendrës Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’, Tiranë”	11271
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 14.11.2018	Për monitorimin shkencor pasvaksinal të kafshëve të vaksinuara në kuadër të projektit “PAZA”	11273
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 14.11.2018	Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën.....	11275
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 74, datë 19.10.2018	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vau i Dejës sh.a.....	11276
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 75, datë 19.10.2018	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas sh.a.....	11280
Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 566, datë 20.11.2018	Për delegim kompetencash.....	11284
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9765/2, datë 14.11.2018	Për shpronësim publik “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 599, datë 31.8.2016, ‘Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i rrugës ‘Dhimitër Konomi’, në zonën e Ujit të Ftohtë’, Vlorë’”.....	11284
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6596/6, datë 15.11.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i një Qendre Multifunksionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara”, në fshatin Poshnjë, Bashkia Ura Vajgurore.....	11286



LIGJ
Nr. 74/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9518, DATË 18.4.2006,
“PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA
PËRDORIMI I ALKOOLIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Erjon Braçe,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në titullin e ligjit, pas fjalëve “nga përdorimi i alkoolit” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 2

Neni 1 riformulohet si më poshtë:

“Neni 1
Qëllimi i ligjit

“Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar nëpërmjet përdorimit të tyre nga të miturit.”.

Neni 3

Në nenin 2, “Objekti i ligjit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “të pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohen paragrafi i tretë dhe i katërt me këtë përmbajtje:

“Në këtë ligj, “pije energjike” konsiderohen ato pije joalkoolike, në të cilat përmbajtja totale e kafeinës tejkalon sasinë 150 mg/l dhe që në përbërje të tyre kanë të paktën një ose më shumë substanca stimuluese ose tonike, të tilla si: taurinë, D-glukuronon y-lakton, guaranë, maltodekstrin, xhensen, karnitinë, kreatinë dhe ginkgo biloba.

Në këtë ligj, “pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar” konsiderohen ato pije

joalkoolike, të gazuara, që përmbajnë sheqer, agjentë të tjerë ëmbëlsues apo aromatizues, natyral apo artificial, si dhe acid ushqimor, përjashtojë ujë mineral dhe ujërat e gazuara, lëngjet e frutave dhe pijet e bërë me qumësht ose produktet e qumështit.”.

Neni 4

Në nenin 3, “Reklama e pijeve alkoolike”, në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve “e pijeve alkoolike” dhe “e përdorimit të alkoolit” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 5

Në nenin 4, “Ndalime për përdorimin e alkoolit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në paragrafin e parë pas fjalëve “e alkoolit” dhe “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ndalohet ofrimi i pijeve alkoolike dhe energjike të miturve nga personi madhor që e shoqëron atë në vende publike.”.

3. Në paragrafin e dytë, pas fjalës “restorant” shtohet fjala “kinema”.

Neni 6

Në nenin 5, “Frekuentimi i lokaleve të natës”, kudo në nen, pas fjalëve “pije alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

Neni 7

Në nenin 7, “Detyrimi për kontroll të dokumentit identifikues”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikat 1 dhe 3, pas fjalëve “pije alkoolike” shtohen fjalët “dhe pije energjike”.

2. Në pikën 3, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “dhe “Ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç””.

3. Në pikën 4, fjalët “Tabela treguese” zëvendësohen me fjalët “Tabelat treguese”.

Neni 8

Në nenin 8, “Ndalimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore”, bëhen këto ndryshime:



1. Në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve “në institucionet arsimore” shtohen fjalët “para-universitare dhe qendrat e mbrojtjes sociale për fëmijë/qendrat e përkujdesjes për fëmijë”.

3. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ndalohet çdo lloj reklamimi i pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në institucionet arsimore për të mitur.”.

Neni 9

Në nenin 9, “Ndalimi i publicitetit për pijet alkoolike në median vizive”, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull, pas fjalëve “i publicitetit për pijet alkoolike” shtohen fjalët “pije energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Ndalohet transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi”.

3. Në paragrafin e dytë pas fjalëve “dhe “konsumojnë pije alkoolike” shtohen fjalët “pije energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 10

Në nenin 10, “Reklamat e pijeve alkoolike”, në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve reklamë e pijeve alkoolike shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 11

Në nenin 11, “Kundërvajtjet administrative”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1, 2 dhe 3, pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1 Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në njësi tregtare, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë.

2/2 Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet, kinematë apo klubet e natës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.”.

3. Në pikën 5, pas fjalëve “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç” shtohen fjalët “dhe “Ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç””.

4. Në pikën 5, pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 12

Në nenin 12, “Dispozita për mediat vizive”, pas fjalëve “pijeve alkoolike” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

1. Radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

2. Për zbatimin e nenit 11, pikat 2/1 dhe 2/2, ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.10.2018

**DEKRET****Nr. 10926, datë 2.11.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, e të nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Valdrin Masar Lluka
2. Jehona Qenan Lluka (Bejtullahu)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10953, datë 15.11.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, e të nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sanije Muharem Alija Sherifi (Alija)
2. Ibrahim Mehmet Yaşar
3. Nëntor Bardhyl Oseku
4. Salahudin Ahmet Keftaro
5. Talal Ahmad Ali Abu-Mayha
6. Ahmet Salim Sebahattin Özdemir

7. Hazis Cemail Vardar
8. Rexhep Islam Morina
9. Remzije Avdulla Morina (Xhyliqi)
10. Labinot Rexhep Morina
11. Azra Alija Morina (Ademi)
12. Shqipron Sokol Brahimi
13. Erdon Sadat Daci
14. Asdren Ismet Ahmeti
15. Abdalnaser Yousef A Alfulaij
16. Rayda Mohammad Mwafaq Al Husni
17. Ron Yitzhak Yeffet (Yefet)
18. Nishant Kishan Chand Taneja
19. Anu Subhash Chander Taneja
20. Mirvete Hysen Hasani
21. Mergim Sami Lushtaku
22. Raif Sami Lushtaku
23. Mërgim Bedri Prishtina
24. Adenis Mefail Shala
25. Lulzim Hamdi Ejupi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 680, datë 14.11.2018****PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË
PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË GUANGZHOU, KINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Guangzhou, Kinë.
 2. Shpenzimet për hapjen e këtij posti konsullor të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
 3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi
Faqe | 11253**



VENDIM

Nr. 681, datë 14.11.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 728, DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s ‘AEGEAN SEA’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjat “a” dhe “b”, data “... 30 nëntor 2018 ...” ndryshohet dhe bëhet “... 30 nëntor 2019 ...”;

b) Në shkronjën “c”, data “... 31 dhjetor 2018 ...” ndryshohet dhe bëhet “... 31 dhjetor 2019 ...”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 682, datë 14.11.2018

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 104, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4003”, ME VENDNDODHJE TE RRAPI I TRESHIT, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për plotësimin e nevojave institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.



3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin atë në përdorim të tretëve.

4. Për ruajtjen dhe sigurinë e pronës nr. 1335, me emërtim “Qendra Zhvillimore e Fëmijëve Autikë”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, që ndodhet në kufi me pronën nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, të cilat janë brenda të njëjtit rrethim, për mënyrën e zbatimit të rregullave të hyrje-daljeve të personelit të strukturave ushtarake, të përdorimit e të mirëmbajtjes së rrjeteve inxhinierike, të linjave të komunikimit elektronik dhe të furnizimit me ujë, energji elektrike e të tjera linja, që janë në përdorim të përbashkët, të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet


Ministrisë së Drejtësisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Armatosura, të përfaqësuar nga Komanda Mbështetëse dhe Batalioni i Mbështetjes i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pronave të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Senida Mesi





VENDIM

Nr. 683, datë 14.11.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË TE
BASHKIA TIRANË, TË NJË PJESE TË
PASURISË SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NR. 4/258, TË “ALBA
FILM” SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2003, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Tiranë, të një pjese të pasurisë shtetërore, me nr. 4/258, të shoqërisë “Alba Film” sh.a., të llojit “truall”, me sipërfaqe 909.5 m², në zonën kadastrale 8130.

2. Vendimi nr. 79, datë 17.2.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të “Alba Film Studio” sh.a. nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Ministria e Brendshme”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi**

VENDIM

Nr. 684, datë 14.11.2018

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË
TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E
NJË KAPANONI INDUSTRIAL
NJË KAT-REPART PËRPUNIMI,
NGA ANA E SHOQËRISË
“LASER TUBE ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 6 213 (gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë) m², sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një kapanoni industrial një kat-repart përpunimi, nga ana e shoqërisë “*Laser Tube Albania*” sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për sipërfaqen prej 6 213 (gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi**



Tokë arë (kategoria VI)

Bashkia	Njësia Administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Durrës	Rrashbull	Stacioni i Zooteknisës, Xhafzotaj	2574	162/114	Shoqëria "Laser Tube Albania" sh.p.k.	Arë	VI	6 213
TOTALI								6 213

VENDIM

Nr. 685, datë 14.11.2018

**PËR MIRATIMIN E PRAKTIKAVE PËR
PROMOVIMIN E INVESTIMEVE TË
PËRBASHKËTA, RAJONALE, NË
INFRASTRUKTURËN E SEKTORIT TË
ENERGJISË***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 4; 9, 11, 16, pikat 1, 4, 5, 13 e 25; dhe 49 e 108, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të neneve 4, pika 2, shkronjat "c" e "ç"; 18, 23, 30 dhe 31, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të neneve 9, 10, 100, pika "ii", dhe të pikës 7, të aneksit I, të Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij vendimi është promovimi i investimeve të përbashkëta, rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë, identifikimin e projekteve me interes për

Komunitetin e Energjisë e të projekteve me interes të ndërsjellë të palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në lidhje me infrastrukturën rajonale të energjisë elektrike, gazit natyror dhe naftës bruto, si dhe të bashkërendojë aktivitetet në lëshimin e lejeve.

II. Fusha e zbatimit

2. Dispozitat e këtij vendimi vlejnë për të gjitha projektet në kategoritë e infrastrukturës rajonale të energjisë elektrike, gazit natyror dhe naftës bruto, të cilat janë projekte me interes për Komunitetin e Energjisë dhe projekte me interes të ndërsjellë të palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

III. Përkufizime

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë këto kuptime:

a) "Infrastrukturë energjetike", çdo pajisje apo impiant fizik, brenda kategorive të infrastrukturës energjetike rajonale, që vendoset brenda territoreve të palëve kontraktuese apo që lidh palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose palët kontraktuese dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;

b) "Vendim gjithëpërfshirës", një vendim apo tërësi vendimesh, që merren nga autoriteti apo autoritetet e një pale kontraktuese, që nuk përfshijnë gjykatat apo kolegjet gjyqësore, që përcaktojnë nëse një promovues i projektit duhet të marrë ose nuk duhet të marrë autorizimin për të ndërtuar infrastrukturën e energjisë për të realizuar projektin, pa paragjykuar vendimet e marra në kontekstin e procedurës administrative në shkallë apeli;

c) "Projekt", një apo më shumë rrjete, tubacione, impiante, pajisje apo instalime që

* Ky vendim është përafëruar pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2013, "Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike transevropiane, që shfuqizon vendimin nr. 1364/2006/EC, si dhe amendon rregulloret (KE) nr. 713/2009, (EC) nr. 714/2009 dhe (EC) nr. 715/2009", të inkuorporuara dhe të përshtatura me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, 2015/09/MC-EnC, të datës 16 tetor 2015, për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike transevropiane".



bëjnë pjesë në kategoritë e infrastrukturës së energjisë;

ç) “Projekt i investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën energjetike me interes”:

i. projekt me interes për Komunitetin e Energjisë është një projekt i nevojshëm për implementimin e infrastrukturës rajonale energjetike, si dhe pjesë e listës së projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë, përmendur në pikën 11, të kreut VII;

ii. projekt me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë është një projekt i infrastrukturës energjetike në një nga kategoritë e elektricitetit, të gazit ose të naftës, që lidh një palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (Shqipërinë) dhe një vend anëtar të BE-së, dhe që është pjesë e listës së projekteve me interes të ndërsjellë, të miratuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, përmendur në pikën 12, të kreut VII;

d) “Ngushtim kapaciteti i infrastrukturës energjetike”, kufizimi i rrjedhave fizike në një sistem energjetik, për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të transmetimit, që përfshin, ndërmjet të tjerash, mungesën e infrastrukturës;

dh) “Promovues i projektit”:

i. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes apo ndonjë operator a investitor tjetër, që zhvillon një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë ose një projekt me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;

ii. operatorë të sistemit të transmetimit, operatorë të sistemit të shpërndarjes, operatorë të tjerë, investitorë apo ndonjë grup i tyre, subjekte me personalitet juridik sipas ligjit të zbatueshëm vendor, që është përcaktuar me marrëveshje kontraktuale ndërmjet tyre, si dhe që kanë kapacitetin për të marrë përsipër detyrime ligjore e financiare në emër të palëve, në rregullimet e tilla kontraktuale.

e) “Rrjet inteligjent”, rrjet elektrik ose rrjet gazi, që mund të integrojë, në mënyrë efektive për koston, sjelljet dhe veprimet e të gjithë përdoruesve të lidhur në të, duke përfshirë prodhuesit (gjeneruesit) e konsumatorët dhe ata që janë njëkohësisht prodhues e konsumatorë, për të siguruar një sistem energjetik ekonomikisht efikas e të qëndrueshëm, me

humbje të vogla dhe nivele të larta të cilësisë, sigurisë së furnizimit dhe sigurisë e rregullit;

ë) “Punime”, blerje, furnizim dhe dërgesë e pjesëve, sistemeve e shërbimeve, duke përfshirë programet kompjuterike, kryerjen e aktiviteteve të zhvillimit, ndërtimit dhe instalimit të projekteve, pranimin e instalimit dhe nisjen e projektit;

f) “Studime”, aktivitete të nevojshme për përgatitjen e implementimit të projektit, siç janë studimet përgatitore, të fizibilitetit, vlerësimit, testimit e vlefshmërisë, duke përfshirë programet kompjuterike, si dhe masat e tjera të mbështetjes teknike, duke përfshirë veprimet paraprake për përcaktimin e zhvillimin e projektit, si dhe vendimmarrjen për financimin e tij, siç janë vëzhgimet në terren për vendndërtimet në fjalë dhe përgatitjen e paketës financiare;

g) “Enti Rregullator i Energjisë (ERE)”, një institucion i pavarur në sektorin e energjisë, që është ngritur, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjeve nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

gj) “Komisionimi”, procesi i futjes së një projekti në veprim, menjëherë pasi të jetë ndërtuar;

h) “Autoritet kompetent”, ministria përgjegjëse për energjinë, institucioni shtetëror përgjegjës për lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë;

i) “Grupi përkatës”, organ i ngritur sipas nenit 3 dhe shtojcës II.1, të rregullores 347/EC, datë 17.4.2013, miratuar me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë nr. 2015/09/MC-EnC, datë 16 tetor 2015;

j) “Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë”, institucioni koordinues i rregullatorëve kombëtarë të energjisë të palëve nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Është forumi për shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin e praktikave më të mira për tregjet e rregulluara të energjisë elektrike dhe të gazit në Komunitetin e Energjisë. Aktivitetet e tij përfshijnë sigurimin e qëndrimeve të koordinuara rregullatore në debatet e politikave energjetike, harmonizimin e rregullave rregullatore përgjatë kufijve dhe ndarjen e njohurive e të përvojës rregullatore;



k) “Palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë”, palët nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

l) “Lista e Projekteve me Interes për Komunitetin e Energjisë (PECI)”, lista e projekteve të miratuara me vendimin e Këshillit Ministror nr. 2015/09/MC-EnC, datë 16 tetor 2015, që do të përditësohet çdo dy vjet;

ll) “Lista e Projekteve me Interes të Ndërsjellë për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (PMI)”, lista e projekteve të miratuara me vendimin e Këshillit Ministror nr. 2015/09/MC-EnC, datë 16 tetor 2015, që do të përditësohet çdo dy vjet;

m) “Studim parafizibiliteti”, një vlerësim paraprak, i përafërt, teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një linje/kapaciteti të ri transmetues të energjisë;

n) “Studim fizibiliteti”, një vlerësim i plotë teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një linje/kapaciteti të ri transmetues të energjisë;

nj) “Interkonektor”, linjë transmetimi, e cila kalon apo përkshon kufirin ndërmjet palëve kontraktuese dhe lidh sistemet shtetërore të transmetimit të palëve kontraktuese;

o) “Tranzit”, transferim i energjisë me origjinë nga një shtet tjetër, e destinuar për një shtet të tretë, nëpër rrjetin shqiptar ose transmetimi i energjisë me origjinë nga një shtet tjetër, i destinuar po për atë shtet, nëpërmjet rrjetit të Shqipërisë;

p) “Depozitim i energjisë”, çdo proces apo gjendje e ruajtjes së energjisë, në një formë, e cila lejon që energjia të vihet në dispozicion në një formë të dobishme në një moment të mëvonshëm.

4. Termat e tjerë të përdorur në këtë vendim, kanë kuptimin sipas përcaktimeve të përdorura në ligjet nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

IV. Kaktimi i autoritetit kompetent shtetëror

5. Autoriteti kompetent shtetëror për lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për promovimin e investimeve

të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë, sipas këtij vendimi, është ministria përgjegjëse për energjinë, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 5, të ligjit nr. 102/2015, në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar, dhe në nenin 13, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar.

6. Ministria përgjegjëse për energjinë përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave praktikat administrative për promovimin e çdo ndërtimi të objekteve të infrastrukturës rajonale energjetike për energjinë elektrike, gazin natyror e naftën bruto dhe këtë veprim ia komunikon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

V. Detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit kompetent

7. Autoriteti kompetent, sipas kreut IV të këtij vendimi, është përgjegjës, për:

a) Lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për projektet e infrastrukturës energjetike, rajonale, me interes për Komunitetin e Energjisë dhe të projekteve me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Autoriteti kompetent bashkërendon dhënien e miratimit gjithëpërfshirës. Në konsultim me autoritetet e tjera të përfshira, si dhe pa paragjykuar afatet kohore, të përcaktuara në përputhje me kreun X, të këtij vendimi, autoriteti kompetent vendos afatet kohore të arsyeshme për secilin rast, brenda të cilave duhen të jepen miratimet individuale nga autoritetet përkatëse. Ai monitoron edhe respektimin e afateve kohore nga autoritetet në fjalë. Nëse një miratim i caktuar nga një autoritet në fjalë nuk jepet brenda afatit kohor të caktuar, autoriteti informon autoritetin kompetent pa vonesë, duke dhënë edhe arsyetimin për mosdhënien e miratimit brenda afatit kohor të caktuar. Në vijimësi, autoriteti kompetent rivendos afatin kohor brenda të cilit jepet miratimi individual derisa, ndërkohë, respektohen afatet e përgjithshme kohore, të vendosura në përputhje me kreun X të këtij vendimi;

b) Publikimin dhe përditësimin, kurdo që është e nevojshme, të manualit të procedurave, në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse që japin leje, para datës 30 dhjetor 2018;



c) Miratimin apo kërkimin e modifikimit të konceptit të pjesëmarrjes publike, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, dorëzuar nga promovuesi i projektit, brenda tre muajve, nga dorëzimi i tij;

ç) Përgatitjen e një skeme të hollësishme afatesh për procesin e dhënies së lejeve, në konsultim me promovuesin e projektit dhe autoritetet e tjera të përfshira;

d) Bashkëpunimin me autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe palët e tjera kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në përgatitjen e planeve të përbashkëta, me qëllim të koordinimit të afateve;

dh) Dorëzimin të grupi përkatës i Komunitetit të Energjisë të raportit vjetor mbi progresin apo vonesat në implementimin e projektit, në kuptimin e proceseve të dhënies së lejeve.

VI. Masat për harmonizimin e procedurave dhe të praktikave

8. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, analizon dhe vlerëson se cilat masa janë të mundshme për harmonizimin e procedurave e të praktikave shtetërore të vlerësimit mjedisor për projektet e infrastrukturës energjetike, rajonale, me interes për Komunitetin e Energjisë dhe të projekteve me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, në bazë të udhëzimeve të nxjerra nga Komisioni Evropian, si dhe informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për rezultatet.

9. Deri më 30 dhjetor 2018, ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, ndërmarrin masat e nevojshme administrative për harmonizimin e procedurave të identifikuar, sipas pikës 8 të këtij vendimi.

10. Duke filluar nga 30 qershor 2019, ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, duhet të ndërmarrin masat ligjore të identifikuar, sipas pikës 8 të këtij kreu. Këto masa duhen marrë pa paragjykuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i miratuar nga Komuniteti i Energjisë.

VII. Statusi prioritar i projekteve rajonale të infrastrukturës energjetike

11. Projektet rajonale të infrastrukturës energjetike, me interes për Komunitetin e

Energjisë (PECI), duhet të marrin statusin prioritar, në mënyrën në të cilën një trajtim i tillë mundësohet me ligjin e zbatueshëm vendor për llojin përkatës të infrastrukturës energjetike. Statusi prioritar i projekteve PECI përfshin edhe dhënien e statusit më të lartë të mundshëm të një çështjeje të rëndësishme kombëtare në planifikimin e territorit, që të trajtohet si e tillë në proceset e dhënies së lejeve, për sa parashikohet në ligjin për planifikim territorial, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me vlerësimet mjedisore.

12. Projektet rajonale të infrastrukturës energjetike me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian (PMI), të cilat janë projekte që lidhin një ose disa palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (p.sh., Shqipërinë dhe një vend anëtar të BE-së), duhet të marrin statusin prioritar, në mënyrën që një trajtim i tillë mundësohet me ligjin e zbatueshëm vendor për llojin përkatës të infrastrukturës energjetike ndërmjet palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Statusi prioritar i projekteve PMI përfshin edhe dhënien e statusit të një çështjeje të rëndësishme kombëtare në planifikimin e territorit, që të trajtohet si e tillë në proceset e dhënies së lejeve, për sa parashikohet në ligjin për planifikim territorial, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me vlerësimet mjedisore.

VIII. Implementimi dhe monitorimi

13. Promovuesit e projekteve të infrastrukturës energjetike rajonale detyrohen të zhvillojnë planet e zbatimit për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë dhe projektet me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë tabelën e afateve kohore për secilën prej këtyre çështjeve, që janë:

a) Studimi i fizibilitetit dhe projektimi;

b) Aprovimi nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe autoritetet e tjera që përfshihen, për rastet kur kërkohet nga legjislacioni specifik;

c) Ndërtimi dhe komisionimi;

ç) Tabela e afateve kohore limit të dhënies së lejeve, për procesin e lejeve, në pajtim me detajet e dhëna me shtojcën II.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



14. Operatori i Sistemit të Transmetimit, si dhe operatorët e tjerë duhet të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për të lehtësuar zhvillimin në fushëveprimin e tyre përkatës të projekteve PECE dhe PMI.

15. Çdo vit, deri më 31 mars, promovuesit e projekteve duhet të dorëzojnë një raport vjetor për secilin projekt që bie në kategoritë e renditura në shtojcën I.1 dhe 2, tek autoriteti kompetent i përmendur në kreun IX, si dhe te bordi i rregullatorit ose, për projektet, që bëjnë pjesë në kategoritë e renditura në shtojcën I.3, te grupi përkatës. Ky raport duhet të japë hollësi, për:

a) Progresin e arritur në zhvillimin, ndërtimin dhe komisionimin e projekteve, sidomos në lidhje me procedurat e dhënies së lejeve e të konsultimit;

b) Vonesat, nëse ka të tilla, në krahasim me planin e zbatimit, arsyet për vonesat e tilla, si dhe vështirësitë e përballura;

c) Planin e rishikuar, nëse ka të tillë, me qëllim tejkalimin e vonesave.

16. Brenda një muaji, nga marrja e raporteve të paraqitura nga promovuesit e projekteve, autoriteti kompetent i dorëzon ato te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, që përgatit dhe dorëzon raportet e konsoliduara te grupet.

17. Çdo vit, autoriteti kompetent i raporton grupit përkatës për progresin dhe për elementet e tjera të rëndësishme, vonesat në zbatimin e projekteve PECE dhe PMI, që gjenden në territorin e tyre, në lidhje me procesin e marrjes së lejeve, si dhe arsyet për vonesa të tilla.

IX. Transparenca dhe pjesëmarrja publike

18. Deri më 30 dhjetor 2018, autoriteti kompetent, në bashkëpunim me autoritetet e tjera të angazhuara, duhet të publikojë një manual procedurash për procesin e dhënies së lejeve, që vlen për projektet PECE dhe PMI. Manuali duhet përditësuar sa herë që është e nevojshme dhe të vihet në dispozicion për publikun. Manuali duhet të përfshijë, së paku, informatat e specifikuar në pikën 1 të shtojcës II.

19. Brenda një periudhe 3-mujore nga fillimi i procesit të dhënies së lejeve, sipas shkronjës “a”, të pikës 27, të kreut X, të këtij vendimi, promovuesi i projektit harton dhe dorëzon tek autoriteti kompetent një projekt konceptual të

pjesëmarrjes publike, bazuar në kërkesat dhe procedurat e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duke respektuar procesin e përcaktuar në manualin e përmendur në pikën 18, si dhe në pajtim me udhëzimet e dhëna te shtojca II. Autoriteti kompetent mund të kërkojë modifikime apo të pajtohet me konceptin e pjesëmarrjes publike brenda dy muajve.

20. Autoriteti kompetent duhet të marrë parasysh çdo formë të pjesëmarrjes dhe konsultimit publik që përdoret para procesit të dhënies së lejeve, referuar dispozitave të ligjit nr. 146/2014, deri në masën që ajo pjesëmarrje dhe konsultim publik të përmbushë kriteret e këtij neni.

21. Në rastet ku promovuesi i projektit synon të bëjë ndryshime të konsiderueshme në një koncept të pjesëmarrjes publike të aprovuar, ai duhet të informojë autoritetin kompetent për këto. Në atë rast, pas konsultimit me autoritetet përkatëse, autoriteti kompetent mund të miratojë modifikimet.

22. Promovuesi i projektit duhet të mbajë, së paku, një konsultim publik ose, kur kërkohet nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në zbatim, para dorëzimit të aplikimit përfundimtar e të plotë tek autoriteti kompetent, sipas shkronjës “a”, të pikës 27, të kreut X. Kjo duhet të bëhet pa anashkaluar konsultimet publike që duhen mbajtur pas dorëzimit të aplikimit për miratim zhvillimor, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Gjatë konsultimeve publike, promovuesi i projektit duhet të informojë palët e interesuara, sipas përcaktimit në pikën 3.1, të shtojcës II, në lidhje me projektin në një fazë të hershme, duhet të kërkojë ndihmë në përcaktimin e vendndodhjes apo të rrugës më të mirë të mundshme, si dhe për çështjet përkatëse, që duhen adresuar në dosjen e aplikimit. Kërkesat minimale, që vlejné për këtë konsultim publik, specifikohen në pikën 5, të shtojcës II.

23. Promovuesi i projektit duhet të përgatisë një raport që përmbledh rezultatet e aktiviteteve në lidhje me pjesëmarrjen publike para se të dorëzojë dosjen e aplikimit, duke përfshirë aktivitetet që janë mbajtur para fillimit të procesit të dhënies së lejeve. Promovuesi i projektit duhet të dorëzojë raportin me dosjen e aplikimit tek



autoriteti kompetent. Këto rezultate duhet të merren parasysh nga autoriteti kompetent kur merret vendimi gjithëpërfshirës.

24. Promovuesi i projektit duhet të krijojë e të mirëmbajë rregullisht një faqe interneti, me të gjitha informacionet e duhura për projektet PEGI dhe PMI, të cilat duhet të jenë të ndërlidhura me faqen e internetit të Komunitetit të Energjisë, si dhe të plotësojnë kërkesat e specifikuara në pikën 6, të shtojcës II. Informacionet e ndjeshme komerciale, që kanë të bëjnë me leverdishmërinë ekonomike të projektit, duhet të mbesin konfidenciale.

25. Promovuesi i projektit duhet të publikojë edhe informacionet përkatëse në mjetet përkatëse të informimit, në të cilat publiku ka akses të gjerë.

X. Kohëzgjatja dhe implementimi i procesit të dhënies së lejeve

26. Promovimi, procesi i dhënies së lejeve dhe kohëzgjatja e tij, për projektet e infrastrukturës energjetike rajonale, që konsiderohen si projekte PEGI dhe PMI, do të bëhet në mbështetje dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, të nenit 31, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, duke pasur në konsideratë dhe duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

27. Procesi i dhënies së lejeve përbëhet nga dy procedura:

a) Procedura para aplikimit, që përfshin periudhën ndërmjet fillimit të procesit të dhënies së lejeve e miratimeve, si dhe të pranimit, nga ana e autoritetit kompetent, të aplikimit të dorëzuar, që përfshin një periudhë indikative, të përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse për secilin aktivitet, energji elektrike, gaz natyror apo naftë bruto.

Kjo procedurë përfshin edhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), si dhe raportet e tjera relevante, që duhen siguruar nga promovuesi i projektit.

Promovuesit e projekteve duhet të njoftojnë me shkrim autoritetin kompetent për projektin dhe të ofrojnë një përshtypje të hollësishme të tij.

Në rast se projekti përfshin dy apo më shumë palë kontraktuese dhe/ose palë të tjera, data e

pranimit të njoftimit të fundit nga autoriteti kompetent në fjalë shërben si data e fillimit të procesit të lejeve;

b) Procedura ligjore e dhënies së lejeve, që mbulon periudhën nga data e miratimit paraprak nga autoriteti kompetent deri në miratimin përfundimtar nga institucionet e ngarkuara me ligj për lëshimin e lejeve për punimet ndërtimore për objekte të infrastrukturës energjetike, sikurse përcaktohet në dispozitat e legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

28. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës rajonale, energjetike, të sektorit të gazit natyror, për projektet PEGI dhe PMI, do të bëhet në referencë të përcaktimeve të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”.

29. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës rajonale, energjetike, të sektorit të energjisë elektrike, për projektet PEGI dhe PMI, do të bëhen në referencë të përcaktimeve të vendimit nr. 16, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e interkonektorëve të rinj”, të ndryshuar.

30. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës rajonale, energjetike, të sektorit të naftës bruto, për projektet PEGI dhe PMI, do të bëhet në referencë të përcaktimeve të vendimit nr. 411, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës së koncesionit të naftës/jellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto”.

XI. Mundësia e investimeve me ndikim ndërkufitar

31. Kostot e investimeve të bëra në mënyrë efikase, të cilat përjashtojnë kostot e mirëmbajtjes, në lidhje me një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë (PEGI) ose me një projekt me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian (PMI), që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1 e 2, të shtojcës I, si dhe që kanë të bëjnë vetëm



me palët kontraktuese, përballohen nga OST-ja përkatëse apo promovuesit e projekteve të infrastrukturës së transmetimit të pala kontraktuese, për të cilët projekti siguron ndikim neto-pozitiv, deri në masën që nuk mbulohet me qiratë e kongestionit apo tarifa të tjera, të cilat do të paguhën nga shfrytëzuesit e rrjetit nëpërmjet tarifave për akses në rrjet brenda asaj apo atyre palëve kontraktuese.

32. Kostot e investimeve të bëra në mënyrë efikase, të cilat përjashtojnë koston e mirëmbajtjes, të ndërlidhura me projekte PECE, që bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në pikat 1 e 2, të shtojcës I, si dhe që kanë të bëjnë me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, mund të përballohen nga OST-ja apo promovuesit e projekteve përkatëse të infrastrukturës transmetuese të palëve kontraktuese dhe shteteve anëtare, për të cilat projekti ofron ndikim neto-pozitiv, deri në masën që nuk mbulohet me qiratë e kongestionit apo tarifa të tjera, të cilat do të paguhën nga shfrytëzuesit e rrjetit nëpërmjet tarifave për akses në rrjet, në atë apo ato palë kontraktuese dhe shtete anëtare të prekura.

33. Mundësia e investimeve me ndikim ndërkufitar realizohet:

a) Për një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë (PECE), që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1, paragrafët 1.1 e 1.3, dhe 2, paragrafi 2.1, të shtojcës I, për të cilin ky kre do të zbatohet vetëm nëse, të paktën, një promovues i projektit kërkon nga autoritetet përkatëse për të aplikuar këtë nen për të gjitha apo një pjesë të kostove të projektit. Për projektet PECE, që bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në paragrafin 2.1, të pikës 2, të shtojcës I, do të zbatohen vetëm në rastet kur vlerësimi i kërkesës së tregut është tashmë i kryer dhe tregon që kostot investuese efikase nuk mund të pritet të mbulohen me tarifë.

b) Për një projekt me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian (PMI), që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1, paragrafët 1.1 e 1.3, dhe 2, paragrafi 2.1, të shtojcës I, për të cilat ky kre do të zbatohet vetëm nëse, të paktën, një promovues i projektit kërkon nga autoritetet përkatëse për të aplikuar këtë nen për të gjitha apo një pjesë të

kostove të projektit. Për projektet PMI, që bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në paragrafin 2.1, të pikës 2, të shtojcës I, ky kre do të zbatohet vetëm në rastet kur vlerësimi i kërkesës së tregut është tashmë i kryer dhe tregon që kostot investuese efikase nuk mund të pritet të mbulohen me tarifë.

34. Në rastet kur projekti ka disa promovues, autoritetet përkatëse rregullatore, shtetërore, kërkojnë nga të gjithë promovuesit e projektit që të dorëzojnë kërkesat për investime bashkërisht, në pajtim me pikën 33 të këtij kreu.

35. Detyrimet e promovuesve të projekteve për informim janë si më poshtë vijon:

a) Për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë (PECE), për të cilat aplikohet pika 31, e këtij kreu, promovuesit e projekteve duhet të informojnë rregullisht Entin Rregullator të Energjisë, së paku një herë në vit, si dhe deri në komisionimin e projektit, për progresin e projektit dhe për identifikimin e kostove dhe ndikimin e tyre;

b) Për projektet me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian (PMI), për të cilat aplikohet pika 31 e këtij kreu, promovuesit e projekteve duhet të informojnë rregullisht Entin Rregullator të Energjisë, së paku një herë në vit, si dhe deri në komisionimin e projektit, për progresin e projektit dhe për identifikimin e kostove dhe ndikimin e tyre.

36. Pasi një projekt i tillë arrin të plotësojë kriteret e përcaktuara me rregullat sipas kreut X të këtij vendimi, promovuesit e projekteve, pas konsultimit me operatorin e sistemit të transmetimit të palës kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në fjalë, për të cilat projekti ofron ndikim të konsiderueshëm neto-pozitiv, duhet të dorëzojnë kërkesën për investime. Një kërkesë e tillë për investime duhet të përfshijë edhe një kërkesë për ndarjen ndërkufitare të koston dhe duhet të dorëzohet tek Enti Rregullator i Energjisë, duke pasur, bashkëngjitur dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Analizën e koston dhe të përfitimit, specifike për projektin, në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga ERE, sipas dispozitave përkatëse të legjislationit për sektorin



e gazit, për sektorin e energjisë elektrike dhe legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, si dhe duke marrë parasysh edhe dobitë përtej kufijve të palës kontraktuese dhe shtetit anëtar në fjalë;

b) Planin e biznesit, që trajton dhe vlerëson rentabilitetin financiar të projektit, duke përfshirë modelin financiar të zgjedhur dhe projektin me interes për Komunitetin e Energjisë apo projektin me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, që i përket kategorisë së përcaktuar në pikën 2, të shtojcës I, duke vlerësuar, po ashtu, edhe rezultatet e testimit të tregut.

37. Nëse bien dakord promovuesit e projekteve për propozimin e arsyetuar për ndarje ndërkufitare të kostos, nëse projekti promovohet nga disa promovues të projekteve, ata duhet të dorëzojnë bashkërisht kërkesën e tyre për investim.

38. Enti Rregullator i Energjisë duhet të ruajë konfidencialitetin e informacioneve komerciale të ndjeshme.

39. Brenda 6 muajve, nga data në të cilën është pranuar kërkesa e fundit për investime nga entet rregullatore respektive, pas konsultimit me promovuesit e projektit në fjalë, rregullatorët marrin vendime të koordinuara për ndarjen e kostove të investimit që duhen përballuar nga secili operator sistemi për atë projekt, bashkë me përfshirjen e tyre brenda tarifave. Enti Rregullator i Energjisë mund të vendosë të ndajë vetëm një pjesë të kostos ose mund të vendosë të ndajë kostot ndërmjet një pakete të disa projekteve PEGI dhe PMI.

40. Kur kostot e tilla të investimit ndahen, Enti Rregullator i Energjisë duhet të ketë parasysh:

a) Tarifën e kongestionit apo tarifat e tjera;

b) Të ardhurat që rrjedhin nga mekanizmi i kompensimit ndërmjet operatorëve të sistemeve, të bëra sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit për sektorin e energjisë elektrike dhe për sektorin e gazit natyror.

41. Në rastet kur vendoset ndarja ndërkufitare e kostos, duhet të merren parasysh kostot dhe përfitimet e projekteve ekonomike, sociale e mjedisore të palës kontraktuese të Komunitetit të

Energjisë dhe shtetet përkatëse anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe nevojat e mundshme për mbështetje financiare.

42. Në vendosjen e ndarjes ndërkufitare të kostos, rregullatorët, në konsultim me operatorët e përfshirë, kërkojnë marrëveshje të ndërsjellë, që bazohet, por pa u kufizuar tek informatat e specifikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 36 këtij kreu.

43. Nëse një projekt PEGI zbut aspektet negative të ndikimeve individuale, siç janë flukset në rajon, dhe ai projekt PEGI apo PMI zbatohet në palën kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian që është vendi i origjinës së pasojës indirekte negative, një zbutje e tillë nuk konsiderohet përfitim ndërkufitar, domethënë nuk përbën një bazë për ndarjen e kostos për operatorin për ato ndikime negative indirekte.

44. Në rast se rregullatorët nuk kanë arritur një marrëveshje për kërkesën për investime brenda 6 muajve, nga data në të cilën është pranuar kërkesa prej tyre, atëherë rregullatori, duke bashkërenduar edhe me rregullatorë të tjerë, duhet të informojë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në këtë rast ose në rastin e kërkesës së përbashkët nga rregullatorët përkatës, vendimi për kërkesën për investime, duke përfshirë ndarjen ndërkufitare të kostos, të përmendur në pikat 33 e 34, si dhe mënyrën në të cilën do të reflektohen kostot në tarifa, duhet marrë parasysh nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, brenda 3 muajve nga data e dërgimit.

Para marrjes së një vendimi të tillë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë duhet të konsultojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, rregullatorët përkatës dhe promovuesit e projektit. Periudha tremujore, siç përmendet në paragrafin më sipër, mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej dy muajsh, nëse kërkohen informata të tjera nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë. Kjo periudhë shtesë fillon në ditën pas marrjes së informacioneve të plota.

45. Vendimi për ndarjen e kostove duhet të publikohet. Procedura vlen për projektet ndërkufitare, që kanë ndikim vetëm ndërmjet palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Çështjet e ndërlidhura me ndarjen e kostove



ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë konsiderohet të jenë zgjidhur vetëm me marrëveshje të ndërsjellë.

46. Kopjet e të gjitha vendimeve për ndarje të kostove, bashkë me të gjitha informacionet e duhura për to, i dërgohen Bordit Rregullator dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Informacionet mund të dërgohen në mënyrë të përmbledhur. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbron konfidencialitetin e informacioneve komerciale të ndjeshme.

47. Vendimi i ndarjes së kostove nuk prek të drejtën e operatorëve për të aplikuar, si dhe të drejtën e rregullatorëve përkatës për të miratuar tarifat për akses në rrjet, në pajtim me dispozitat e legjislacionit për energjinë, si dhe përshtatjet që janë bërë për Komunitetin e Energjisë.

XII. Politikat nxitëse

48. Në rastet kur promovuesi i projektit bart rreziqe më të mëdha për zhvillimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një projekti PECEI apo PMI, që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në shtojcat I, pikat 1, paragrafët 1.1 e 1.3 dhe 2, në krahasim me rreziqet që normalisht ekzistojnë në projekte të krahasueshme infrastrukture, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) duhet të sigurojë që operatorët e sistemit dhe përdoruesit e tij të gëzojnë politika nxitëse përkatëse, në terma afatgjatë e afatshkurtër, për të rritur efikasitetin e sistemit dhe për të mundësuar integrimin e tregut, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të energjisë dhe legjislacionit përkatës të miratuar nga Komuniteti i Energjisë.

49. Pas datës 31 dhjetor 2018, ERE duhet të miratojë e të publikojë metodologjinë, kriteret që përdoren në vlerësimin e investimeve në projektet rajonale të infrastrukturës së energjisë elektrike dhe gazit, si dhe risqet e mëdha me të cilat ato përballen.

XIII. Kualifikimi i projekteve për ndihmë teknike dhe financiare nga BE-ja

50. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë (PECEI) apo projektet me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian (PMI), që bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1 e 2, të shtojcës I, mund të kualifikohen për ndihmë teknike dhe financiare nga Bashkimi Evropian, në formë grantesh për

studime, dhe nga instrumentet financiare: Instrumenti për Ndihmë Paraasociimit (IPA) dhe Instrumenti i Investimeve në Fqinjësi.

51. Projektet PECEI apo PMI, që bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të shtojcës I, mund të kualifikohen për ndihmë financiare në formë grantesh nga Instrumenti për Ndihmë Paraasociimit (IPA) dhe Instrumenti i Investimeve në Fqinjësi, përveç projekteve që lidhen me depozitimin e energjisë elektrike me hidropompa.

Projektet e parashikuara në këtë pikë mund të kualifikohen nëse plotësojnë këto kriteret:

a) Analiza kosto-përfitim, që është specifike për projektin, në përputhje me metodologjinë e zhvilluar e të publikuar nga rregullatori dhe legjislacionin përkatës për energjinë, sugjeron prova në lidhje me ekzistencën e ndikimeve të jashtme, të rëndësishme, pozitive, të tilla si siguria e furnizimit, solidariteti ose inovacioni;

b) Kur ofrojnë shërbime nëpërmjet kufijve, duke sjellë inovacion teknologjik, garantojnë sigurinë e operimit ndërkufitar të rrjetit, synojnë ndarjen ndërkufitare të kostos së projektit ose projektet PECEI e PMI, që bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në nënpikën 1.2, të pikës 1, të shtojcës I, dhe të cilat nuk përfshihen në vendime për ndarjen e kostove ndërkufitare;

c) Projekti nuk është ekonomikisht rentabël, sipas planit të biznesit dhe vlerësimeve të tjera që janë bërë, kryesisht nga investitorët, kreditorët potencialë apo vetë Enti Rregullator i Energjisë, por ka ndikime të jashtme, të rëndësishme, pozitive, të tilla si siguria e furnizimit, solidariteti ose inovacioni.

52. Vendimi për politikat nxitëse dhe arsyetimet e tij, të parashikuara në kreun XII, duhen marrë parasysh kur vlerësohet rentabiliteti ekonomik i projektit.

53. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë dhe projektet me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, që bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të shtojcës I, mund të kualifikohen për ndihmë financiare nga BE-ja në formë të granteve për punë nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 51 të këtij kreu.



XIV. Raportimi

54. Autoriteti kompetent duhet të përgatisë raportin e progresit të arritur në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë, për projektet me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe, kur është e nevojshme, t'i dorëzojë këto raporte te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

55. Çdo vit, autoritetet kompetente, të përmendura në kreun VIII duhet të raportojnë te grupi përkatës i Komunitetit të Energjisë për progresin dhe, atje ku është e përshtatshme, për vonesat në implementimin e projekteve PEGI e PMI, që gjenden në territorin e tyre përkatës, në lidhje me proceset e dhënies së lejeve, si dhe mbi arsyet për vonesat.

XV. Dispozita të fundit

56. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë, që veprojnë në kuadër të tagrit të tyre të përcaktuar sipas ligjeve nr. 102/2015, nr. 43/2015, të ndryshuar, dhe nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, sigurojnë monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë.

57. Praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë, siç janë përcaktuar në këtë vendim, janë të aplikueshme në projekte që lidhin Shqipërinë me vende palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose me vende anëtare të Bashkimit Evropian, që do të jenë efektive në infrastrukturën e:

- a) Transmetimit të energjisë elektrike;
- b) Transmetimit, të depozitimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar;
- c) Transportimit të naftës bruto.

58. Shtojcat I dhe II që i bashkëlidhen këtij vendimi, janë pjesë përbërëse të tij.

59. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi

SHTOJCA I

KATEGORITË DHE FUSHAT E INFRASTRUKTURËS SË ENERGJISË

Kategoritë e infrastrukturës së energjisë që mund të zhvillohen janë energjia elektrike, gazi dhe nafta.

1. Në lidhje me energjinë elektrike:

1.1 Rrjetet e transmetimit të tensionit të lartë, nëse janë projektuar për tension prej 220 kV apo më shumë, si dhe kablllo nëntokësore dhe nënujore të transmetimit, nëse janë projektuar për tension prej 150 kV apo më shumë;

1.2 Objektet e depozitimit të energjisë elektrike që përdoren për depozitimin e energjisë elektrike në baza të përhershme apo të përkohshme, në vendndodhje infrastrukture apo gjeologjike mbi apo nën tokë, me kusht që të jenë drejtpërdrejt të lidhura në linja transmetuese të tensionit të lartë, të projektuara për tension prej 110 kV apo më shumë;

1.3 Pajisje apo instalime të nevojshme për sistemet e përcaktuara te pikat 1.1 dhe 1.2 për të operuar në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe efikase, duke përfshirë sistemet e mbrojtjes, monitorimit dhe kontrollit në të gjitha nivelet e tensionit dhe nënstacioneve;

1.4 Pajisje apo instalime, në nivel të transmetimit dhe të shpërndarjes në tension të mesëm, që synojnë komunikimin dydrejtimësh digjital, në kohë reale apo afër kohës reale, monitorimin dhe menaxhimin interaktiv dhe inteligjent të gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe konsumit të energjisë elektrike, brenda një rrjeti elektrik, me qëllim zhvillimin e rrjetit që në mënyrë efikase integron sjelljet dhe veprimet e të gjithë shfrytëzuesve të lidhur në të - gjeneratorët, konsumatorët dhe ata që i bëjnë të dyja - për të siguruar një sistem ekonomikisht efikas, të qëndrueshëm të energjisë elektrike me humbje të ulëta dhe cilësi të lartë dhe siguri të furnizimit dhe siguri të përgjithshme;

2. Në lidhje me gazin natyror:

2.1 Gazsjellësit transportues për transportimin e gazit natyror dhe të biogazit, që bëjnë pjesë në një rrjet që kryesisht përmban tubacione të presionit të lartë, duke përjashtuar gazsjellësit e presionit të lartë që përdoren për kërkim-prodhimin apo shpërndarjen lokale të gazit natyror;



2.2 Instalimet e depozitimit, nëntokësore, të lidhura në gazsjellësit e lartpërmendur të presionit të lartë;

2.3 Instalimet e pranimit, depozitimit dhe rigazifikimit apo dekompresimit për gazin natyror të lëngëzuar (GNL) apo gazin natyror të kompresuar (GNK);

2.4 Çdo pajisje apo instalim që është i nevojshëm për të pasur një sistem që operon në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe efikase apo që mundëson kapacitet dydrejtimësh, duke përfshirë stacionet e kompresorëve;

3. Në lidhje me naftën:

3.1 Naftësjellësit e përdorur për transportimin e naftës bruto;

3.2 Stacionet e pompimit dhe instalimet e depozitimit të nevojshme për operimin me naftësjellës të naftës bruto;

3.3 Çdo pajisje apo instalim që është i nevojshëm për të pasur një sistem që operon në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe efikase, duke përfshirë sistemet e mbrojtjes, monitorimit dhe kontrollit, si dhe pajisjet për rrjedhën e kundërt;

4. Fushat tematike prioritare për zhvillim

Shtirja e rrjeteve inteligjente: marrja përsipër e teknologjive inteligjente të rrjetit në të gjithë Komunitetin e Energjisë për të integruar në mënyrë efikase sjelljen dhe veprimet e të gjithë përdoruesve të lidhur në rrjetin elektrik, sidomos gjenerimin e sasive të mëdha të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme apo të shpërndara të energjisë, si dhe reagimit për kërkesën, nga konsumatorët.

SHTOJCA II

UDHËZIMET PËR TRANSPARENCË DHE PJESËMARRJE PUBLIKE

1. Manuali i procedurave i përmendur në pikën 18, të kreut IX, së paku duhet të specifikojë:

1.1 Ligjin përkatës tek i cili bazohen vendimet dhe mendimet për llojet e ndryshme të projekteve përkatëse me interes për Komunitetin e Energjisë dhe/ose projekteve me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ato mjedisore;

1.2 Vendimet dhe mendimet përkatëse që duhen marrë;

1.3 Emrat dhe hollësitë për kontakt të autoritetit kompetent, autoriteteve të tjera dhe palëve kryesore me interes të përfshira;

1.4 Rrjedha e punës, që përshkruan çdo fazë të procesit, duke përfshirë një kuadër kohor indikativ dhe një pasqyrë të përmbledhur të procesit të vendimmarrjes;

1.5 Informacionet për fushëveprimin, strukturën dhe nivelin e detajimit të dokumenteve që duhen dorëzuar me aplikimin për vendime, duke përfshirë listën kontrolluese;

1.6 Fazat dhe mënyrat në të cilat publiku i gjerë mund të marrë pjesë në proces.

2. Skemat e hollësishme të përmendura në kreun X duhet të specifikojnë, minimalisht, sa vijon:

2.1 Vendimet dhe mendimet përkatëse që duhen marrë;

2.2 Autoritetet, palët e përfshira, si dhe publikun që është e mundur që do të ndikohen;

2.3 Fazat individuale të procedurës, si dhe kohëzgjatjen e tyre;

2.4 Momentet kryesore që duhen arritur, si dhe afatet përfundimtare të tyre në lidhje me vendimin gjithëpërfshirës që duhet marrë;

2.5 Burimet e planifikuara nga autoritetet dhe nevojat e mundshme për burime shtesë.

3. Për të rritur pjesëmarrjen publike në procesin e dhënies së lejes dhe për të siguruar paraprakisht informimin dhe dialogun me publikun, do të respektohen këto parime:

3.1 Palët me interes të prekura nga një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë dhe/ose një projekt me interes të ndërsjellë për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë autoritetet përkatëse shtetërore, rajonale dhe lokale, pronarët e tokave dhe qytetarët që jetojnë në afërsi me projektin, publikun e gjerë dhe shoqatat, organizatat dhe grupet e tilla, duhen informuar e konsultuar gjerësisht në fazë të hershme, kur shqetësimet e mundshme të publikut ende mund të merren parasysh, si dhe në mënyrë të hapur e transparente. Aty ku është e aplikueshme, autoriteti kompetent në mënyrë aktive përkrah aktivitetet e ndërmarra nga promovuesi i projektit.

3.2 Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që procedurat e konsultimit publik për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë dhe/ose për projektet me interes të ndërsjellë për palët



kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të grupohen bashkë kurdo që është e mundur. Secili konsultim publik duhet të mbulojë të gjitha çështjet e rëndësishme për fazën e caktuar të procedurës, ndërsa një çështje e rëndësishme për fazën e caktuar të procedurës nuk duhet adresuar në më shumë se një konsultim publik; megjithatë, një konsultim publik mund të bëhet në më shumë se një vendndodhje gjeografike. Lëndët e adresuara në një konsultim publik duhet të pasqyrohen qartë në njoftimin për konsultim publik.

3.3 Komentet dhe kundërshtimet do të jenë të pranueshme që nga fillimi i konsultimeve publike e deri në skadimin e afatit.

4. Koncepti i pjesëmarrjes publike më së paku duhet të përfshijë informacione, mbi:

4.1 Palët me interes që preken dhe adresohen;

4.2 Masat e parashikuara, duke përfshirë vendndodhjet dhe datat e propozuara të takimeve të dedikuara;

4.3 Afatet kohore;

4.4 Burimet njerëzore që dedikohen për detyrat përkatëse.

5. Në kontekstin e konsultimeve publike, që duhen mbajtur para dorëzimit të dosjes së aplikimit, palët përkatëse, më së paku, duhet që:

5.1 Të publikojë një broshurë informuese me jo më shumë se 15 faqe, e cila ofron, në mënyrë të qartë dhe koncize, një pasqyrë të qëllimit dhe afateve paraprake kohore të projektit, planin shtetëror të zhvillimit të rrjetit, rrugët alternative të marra parasysh, ndikimet e pritura, duke përfshirë ato të natyrës ndërkufitare, si dhe masat e mundshme zbutëse, të cilat duhen publikuar para fillimit të konsultimit; broshura informuese për më tepër duhet të paraqesë adresat e internetit të platformës së transparencës dhe të manualit të procedurave nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

5.2 Të informojë të gjitha palët e prekura për projektin përmes faqes së internetit të përmendur në pikën 24, të kreut IX, si dhe për mënyrat e tjera të përshtatshme të informimit sipas këtij vendimi.

5.3 Të ftojë në formë të shkruar palët e përkatëse të prekura në takime të dedikuara, gjatë të cilave mund të diskutohen pretendimet e mundshme.

6. Faqja e internetit për projektin duhet të vëre në dispozicion, më së paku, sa vijon:

6.1 Broshurën informuese të përmendur në pikën 5 më sipër;

6.2 Një përmbledhje joteknike dhe rregullisht të përditësuar, me jo më shumë se 50 faqe, që reflekton gjendjen aktuale të projektit, si dhe që paraqet qartë, në rast të përditësimeve, ndryshimet në versionet e mëparshme;

6.3 Planifikimin e projektit dhe të konsultimeve publike, që reflekton qartë datat dhe lokacionet për konsultime dhe dëgjime publike dhe çështjet e parashikuara të duhura për ato dëgjime;

6.4 Informacionet për kontakte, me qëllim të sigurimit të tërësisë së plotë të dokumenteve të aplikimit;

6.5 Informacionet për kontakte me qëllim të parashtrimit të komenteve dhe kundërshtimeve gjatë konsultimeve publike.

VENDIM

Nr. 687, datë 14.11.2018

PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE TË SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Sportistët që kanë arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, konsiderohen sportistë të nivelit të lartë dhe gëzojnë status e trajtim të veçantë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

2. Sportistët gëzojnë statusin e sportistit të nivelit të lartë nga momenti i marrjes së rezultatit zyrtar në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1.1 dhe 2.1, të kreut II, të këtij vendimi, deri në marrjen zyrtare të të njëjtit rezultat nga një sportist tjetër pasardhës.



3. Sportistët, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare.

II. Kriteret e përcaktimit të statusit të sportistit të nivelit të lartë dhe mënyra e shpërblimit

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare:

1.1 Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv për të rritur, në sportet individuale në përbërje të ekipit kombëtar, si dhe në ekipet kombëtare të sporteve kolektive, për sportet olimpike të përcaktuara dhe të miratuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, të jenë rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare zyrtare, sipas klasifikimeve përfundimtare të përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

- a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik;
- b) Sportisti, i cili thyen rekord botëror;
- c) Sportisti, i cili thyen rekord evropian;
- ç) Vendi i parë deri në vendin e tetë në Lojërat Olimpike;
- d) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore;
- dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë në kampionate evropiane;
- e) Vendi i parë në Lojërat Mesdhetare.

1.2 Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

1.3 Sportistët që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1 të këtij kreu, shpërblehen sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.4 Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv për të rinjtë janë të njëjta me ato sipas pikës 1.1 të këtij kreu. Kategoria e të rinjve shpërblehen në masën 30% të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tabelës I që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.5 Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë shpërblehen në masën 40% të vlerës së përcaktuar për sportistët fitues sipas kategorizimeve në tabelën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.6 Klasifikimi i ekipeve dhe shuma përfituese për sportet kolektive përcaktohet në tabelën II që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Nga kjo shumë, komitetet drejtuese të federatave sportive përcaktojnë shpërblimin e sportistëve në sportet kolektive, i cili është individual dhe bazohet në kontributin e secilit.

1.7 Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1 të këtij kreu, marrin trajtim të veçantë, lidhur me:

- a) Ndjekjen e studimeve pa procedura konkurrimi në Universitetin e Sporteve, Akademinë e Sigurisë dhe Akademinë e Mbrojtjes;
- b) Ndjekjen e studimeve me plane individuale në institucionet e arsimit të lartë;
- c) Punësimin në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.

2. Në veprimtaritë kombëtare:

2.1 Kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv në veprimtaritë kombëtare janë rezultatet e arritura, si më poshtë vijon:

- a) Sportisti, i cili thyen rekordin kombëtar;
- b) Vendi i parë në kampionatin kombëtar.

2.2 Shpërblimi, sipas masës së përcaktuar në tabelën III që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, mbulohet nga buxhetet e federatave përkatëse sportive.

III. Trajtimi i sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve

1. Sportistët pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare të përcaktuara në rregulloret kombëtare dhe në veprimtari ndërkombëtare, për përgatitjen e tyre, përfitojnë trajtim ushqimor në natyrë ose në vlerë, si dhe trajtim mjekësor.

2. Trajtimi ushqimor është 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj. Trajtimi mjekësor dhe riaftësimi i sportistëve është deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Trajtimi ushqimor dhe mjekësor mbulohet plotësisht ose pjesërisht nga klubet sportive, me fondet e pushtetit vendor, nga fondi grant ose të ardhura të tjera të ligjshme.

4. Trajnerët e kontraktuar me kohë të pjesshme pranë klubeve sportive/shumësportesh do të paguhet në masën 500 (pesëqind) lekë për orë stërvitore dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) lekë në ditë për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj.



5. Federatat dhe klubet mund të grumbullojnë ekipet e tyre përfaqësuese për veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. Vlera ditore për akomodimin dhe ushqimin është 7 000 (shtatë mijë) lekë (4 000 lekë ushqimi + 3 000 lekë fjetja) në ditë, sipas nevojave që ato kanë, dhe mbulohet nga buxhetet e federatave apo klubeve, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

IV. Dispozita të fundit

1. Efektet financiare për zbatimin e pikave 1.1 deri në 1.5, të kreut II, të këtij vendimi, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin.

2. Efektet financiare për zbatimin e pikës 1.6, të kreut II, të këtij vendimi, dhe shpërblimet e dhëna nga ministri përgjegjës për sportin, deri në 500 000 (pesëqind mijë lekë), për veprimtari të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, në sporte

individuale dhe në përbërje të ekipeve kombëtare, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin.

3. Vendimi nr. 1720, datë 29.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela I

KLASIFIKIMI NË RENDITJE INDIVIDUALE, SPORTET INDIVIDUALE DHE SHPËRBLIMET

Kampionat evropian	Vendi i parë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	7 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	5 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	3 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Rekord olimpik		15 000 000 lekë
Rekord botëror		15 000 000 lekë
Rekord evropian		8 000 000 lekë

Tabela II

KLASIFIKIMI NË RENDITJE EKIPORE DHE SHPËRBLIMI NË VEPRIMTARITË
NDËRKOMBËTARE

Lojëra olimpike	Vendi i parë	20 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	15 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	15 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	7 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i parë	7 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	5 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	4 000 000 lekë

Tabela III

SHPËRBLIMET PËR FITUESIT NË VEPRIMTARITË KOMBËTARE

Rekord kombëtar		30 000 lekë
Ekipi kampion kombëtar në sportet individuale	Vendi i parë	20 000 lekë
Ekipi kampion në lojëra	Vendi i parë	200 000 lekë
	Vendi i dytë	100 000 lekë
	Vendi i tretë	50 000 lekë

VENDIM

Nr. 688 , datë 14.11.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TE FONDI SHQIPTAR I
ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT ME
EMËRTIM “OBORR I QENDRËS
SPITALORE UNIVERSITARE ‘NËNË
TEREZA’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Fondit Shqiptar i Zhvillimit, të një pjese të oborrit të brendshëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, me sipërfaqe 10 457 m², zona kadastrale nr. 8130, në njësinë administrative nr. 3, Bashkia Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim shfrytëzimin

për parkim, përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tretë që nuk janë në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Nga aktiviteti që do të zhvillojë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe, do të përfitojë 55% të të ardhurave, ndërsa Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, do të përfitojë 45% të të ardhurave.

4. Vlera prej 45% e të ardhurave, si pjesë takuese e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, do të ndahet sipas modalitetit të mëposhtëm:

a) 3% do të kalojë në llogarinë e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, me destinacion edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre;

b) 42% do të investohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me kërkesë të Qendrës Spitalore



Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe pas miratimit paraprak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përbushje të objektivave dhe të misionit të saj.


5. Marrëdhëniet ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit do të rregullohen me marrëveshje të përbashkët.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit,

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



**VENDIM****Nr. 689, datë 14.11.2018****PËR MONITORIMIN SHKENCOR
PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË
VAKSINUARA NË KUADËR TË
PROJEKTIT “PAZA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 61/2016, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e gjuetisë së dhelprës së kuqe, për arsye të monitorimit shkencor pasvaksinal, që realizohet në kuadër të projektit “Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit ndaj sëmundjeve zoonotike” (PAZA), për fazën e dhjetë dhe të fundit të projektit.

2. Gjuetia e dhelprës së kuqe, me qëllim marrjen e kampionëve të dhelprës, të kryhet në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura, për 40 ditë, të shtrira brenda periudhës 10 dhjetor 2018–15 shkurt 2019, në ditët nga e hëna deri në të premten, duke filluar kjo gjueti nga dita që lëshohet autorizimi për këtë qëllim.

3. Për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, nëpërmjet gjuajtjes së tyre, të angazhohen në të gjithë vendin 39 (tridhjetë e nëntë) punonjës të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të pajisur me shenjë dalluese për këtë proces, që do të sigurojnë në total 324 (treqind e njëzet e katër) kampionë të dhelprave të kuqe. Numri i personave që do të realizojnë marrjen e kampionëve në çdo qark, si dhe numri i kampionëve të dhelprave që do të sigurohen për secilin qark, jepen në tabelën që i bashkëlidhet

këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Detajimi i punonjësve përkatës që do të marrin pjesë në këtë proces të bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

4. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit pajis me autorizimin përkatës për marrjen e kampionëve të dhelprës së kuqe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në çdo qark, brenda 5 (pesë) ditëve nga data që merr kërkesën për monitorim të dhelprave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për realizimin e fazës së dhjetë të projektit.

5. Gjatë të gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku të kryhet marrja e kampionëve të dhelprave, procesi do të kontrollohet nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, si dhe Policia e Shtetit.

6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkërendojë punën për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, për dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, për analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe për raportimin e këtyre rezultateve pas përfundimit të fazës së dhjetë të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



**PËR MONITORIMIN SHKENCOR PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË
VAKSINUARA, NË KUADËR TË PROJEKTIT “PAZA”
(FAZA 10)**

NUMRI I PUNONJËSVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA
QË DO TË SIGUROJNË KAMPIONËT LABORATORIKË,
NUMRI I KAMPIONËVE TË DHELPRAVE TË KUQE

Nr.	Qarku	Bashkia	Nr. i punonjësve të AKZM-së në çdo qark	Nr. i kampionëve të dhelprave	
				Qark	Bashki
1	BERAT		5	21	
		Berat			12
		Kuçovë			2
		Skrapar			3
		Polican			2
		Ura Vajguore			2
2	DIBËR		3	24	
		Dibër			10
		Bulqizë			7
		Mat			4
		Klos			3
3	DURRËS		3	10	
		Durrës			3
		Shijak			3
		Krujë			4
4	ELBASAN		3	37	
		Elbasan			8
		Belsh			4
		Cërrik			4
		Librazhd			5
		Përrenjas			4
		Peqin			4
		Gramsh			8
5	FIER		4	24	
		Fier			6
		Lushnjë			6
		Divjakë			3
		Roskovec			2
		Mallakastër			4
		Patos			3
6	GJIROKASTËR		2	38	
		Gjirokastrë			12
		Libohovë			5
		Tepelenë			6
		Memaliaj			4
		Përmet			7
		Këlcyrë			2



		Dropull			2
7	KORÇË		4	53	
		Korçë			14
		Maliq			5
		Devoll			4
		Pustec			3
		Kolonjë			14
		Pogradec			13
8	KUKËS		1	20	
		Kukës			8
		Tropojë			11
		Has			1
9	LEZHË		5	12	
		Lezhë			3
		Kurbini			3
		Mirditë			6
10	SHKODËR		2	36	
		Shkodër			12
		Vau i Dejës			4
		Malësi e Madhe			14
		Pukë			4
		Fushë-Arrëz			2
11	TIRANË		5	13	
		Tiranë			4
		Vorë			2
		Kamzë			2
		Kavajë			3
		Rrogozhinë			2
12	VLORË		2	36	
		Vlorë			20
		Sarandë			2
		Konispol			2
		Finiq			4
		Delvinë			4
		Himarë			2
		Selenicë			2
	TOTALI		39		324

VENDIM

Nr. 690, datë 14.11.2018

**PËR PRODHIMIN, TRANSMETIMIN
DHE FINANCIMIN E EMISIONEVE TË
POSAÇME TELEVIZIVE, ARSIMORE
DHE KULTURORE, TË DEDIKUARA
PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të nenit 116, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008,

“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prodhimin, transmetimin dhe financimin nga buxheti i shtetit të emisioneve të posaçme televizive, për mësimin e gjuhës shqipe dhe për kulturën shqiptare, të dedikuara për diasporën, si pjesë të programit “RTSH 3”, të Radio-televizionit Shqiptar (RTSH).



2. Emisioni i posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe prodhohet e transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) dhe financohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Emisioni i posaçëm televiziv për kulturën shqiptare, si prodhim i pavarur i Ministrisë së Kulturës, transmetohet nga Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH), me financimin e buxhetit të miratuar për ministrinë.

4. Përmbajtja e programeve të emisionit të posaçëm televiziv për mësimin e gjuhës shqipe do t'u kushtohet interesave të arsimimit për komunitetet shqiptare jashtë vendit, sipas kurrikulës së përbashkët të realizuar për këtë qëllim, në bazë të marrëveshjes me qeverinë e Republikës së Kosovës.

5. Platforma e programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar të përgatitet nga një grup pune ndërinstitucional, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me përfaqësues të ministrive përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën.

6. Transmetimet e programeve të miratuara do të inkurajojnë mësimdhënien *online* dhe, pas transmetimit periodik në "RTSH 3", do të vihen në dispozicion të publikut të interesuar pa pagesë.

7. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës, për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të lidhin marrëveshjet përkatëse me Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH).

8. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri i Shtetit për Diasporën, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, në bashkëpunim me Radiotelevizionin Shqiptar, të marrin masat e nevojshme për realizimin e emisioneve të posaçme dhe transmetimin e tyre, duke filluar nga viti i ri mësimor 2019–2020.

9. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe ministri përgjegjës për diasporën të mbështesin Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH) për zbatimin e marrëveshjes me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) për realizimin, brenda vitit 2019, të programit të përbashkët televiziv mbi bazën e interesave të diasporës shqiptare.

10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 74, datë 19.10.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
VAU I DEJËS SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102., datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi nr. 39); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 19.10.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Vau i Dejës sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,



VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vau i Dejës (UK Vau i Dejës), me shkresën nr. 542 prot., datë 30.3.2018, me lëndë: “Kërkesë për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtjeje rrjeti të ujësjiellës”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për unifikimin e tarifave në të gjithë zonën e shërbimit, të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Vau i Dejës, në përputhje me

përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendim nr. 30, datë 16.2.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Vau i Dejës, për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK, për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. UK Vau i Dejës, nëpërmjet shkresës nr. 542 prot., datë 30.3.2018, me lëndë: “Kërkesë për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtjeje rrjeti të ujësjiellës”, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për unifikimin e tarifave në të gjithë zonën e shërbimit, sipas tabelës:

Kategoria	Për konsumatorët me matës		Për konsumatorët pa matës
	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse	Tarifa aforfe
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	Lekë/m³	Lekë/muaj	Lekë/muaj
1. Konsumator familjar	42	83	667
2. Konsumator publik	120	167	-
3. Konsumator privat	120	167	-
b) Për shërbimin e kanalizimeve	Lekë/m³	Lekë/muaj	Lekë/muaj
1. Konsumator familjar	7	-	83
2. Konsumator publik	20	-	167
3. Konsumator privat	20	-	167

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruar, rezulton:

a) Për vitin 2019, UK Vau i Dejës ka parashikuar kosto operative dhe mirëmbajtjeje (O&M) rreth 2 milionë lekë më të larta, krahasuar me vitin 2018, ndërsa të ardhurat janë parashikuar të rriten me rreth 7.6 milionë lekë. Ky parashikim i të ardhurave dhe i shpenzimeve do të sjellë rritje të nivelit të mbulimit të kostove O&M, nga 33% në vitin 2017 në 48% për vitin 2018 (i pritshmi) dhe në nivelin 67% për vitin 2019 (parashikimi).

b) Uji pa të ardhura për UK Vau i Dejës, për vitin e kaluar, është 54%. Humbjet vjetore janë 448.174 m³/vit, nga të cilat 70% janë humbje administrative dhe 30% janë humbje teknike. Shoqëria parashikon që për vitin 2019, uji pa të ardhura do të arrijë të ulët në 49%.

c) Niveli i matjes paraqitet në nivele të mira për vitin 2017, rreth 76%. Sipas të dhënave të operatorit, është punuar shumë për të pajisur me matës të gjithë konsumatorët. Në qytetin e Vaut të Dejës janë instaluar rreth 400 matës, në Bushat dhe Barbullush rreth 95% e lidhjeve janë pajisur me matës, në Malin e Jushit rreth 90% dhe në Ranxa 85% e konsumatorëve janë të pajisur me matës. Në disa fshatra, si: Kukël, Shkjezë etj., faturohet aforfe, pasi nuk ka matës të instaluar. Operatori ka për synim pajisjen me matës të të gjithë konsumatorëve dhe parashikon që në vitin 2019 ky tregues në total të arrijë vlerën 91%.

d) Kohëzgjatja mesatare e orëve të furnizimit me ujë është 6 orë në ditë, sipas zonave orët e furnizimit variojnë nga 3,5 në 24 orë në ditë. Me nismën për rehabilitimin e tubacioneve, me uljen



e humbjeve në rrjet, operatori parashikon për vitin 2019 furnizim me ujë të arrijë në 15 orë në ditë.

e) Norma e arkëtimit e përgjithshme është rreth 82% dhe parashikohet që në vitin 2019 të arrihet norma e arkëtimit në masën 92%. Operatori ka përmirësuar mënyrat e arkëtimit të faturave nëpërmjet organizimit të stafit, shtimit të numrit të qendrave të pagesave dhe mënyrave se si paguhet (arkë, bankë, pranë njërive administrative). Kjo është shoqëruar, gjithashtu, me një fushatë intensive të informimit publik.

f) Nga 52.000 banorë në zonën e juridiksionit përfitojnë shërbimin e furnizimit me ujë, nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit, rreth 13 800 banorë ose rreth 26% e popullsisë. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, rreth 19% furnizohen me puse.

g) Shërbimi i largimit të ujërave të ndotura do të ofrohet vetëm për zonat urbane Bushat dhe Vau i Dejës, për rreth 10.000 banorë.

h) Treguesi i efikasitetit të stafit aktualisht është 9 punonjës për 1000 lidhje UK. Nevojat për staf për përbalimin e shërbimit cilësor janë më të larta, pasi zona e shërbimit nuk ka një sistem unik furnizimi me ujë, por paraqitet mjaft e fragmentarizuar, sepse përbëhet nga shumë sisteme të vogla të veçanta të furnizimit me ujë të shpërndara në të gjithë zonën e shërbimit, që secila kërkon personel më vete.

5. Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Vau i Dejës argumentohet, me:

a) Shoqëria aplikon për herë të parë, sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara dhe më pas përcaktimi i objektivave për treguesit e performancës.

b) Shoqëria është e formuar rishtas dhe përfshin në zonën e saj të shërbimit të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Vau i Dejës, mbas reformës administrative territoriale.

c) Shoqëria paraqitet mjaft problematike në drejtim të performancës financiare që mbulon vetëm 33% të kostove direkte të O&M dhe paraqitet më se e domosdoshme rritja e tarifave

të shërbimit të furnizimit me ujë dhe e kanalizimeve të ujërave të ndotura, në mënyrë që gradualisht të mbulohen të paktën kostot direkte të O&M të shoqërisë.

d) Domosdoshmëria e rritjes së cilësisë së shërbimit që aktualisht ka një mesatare furnizimi me ujë prej 6 orë në ditë.

e) Megjithëse, duke pasur parasysh gjendjen e sektorit në rang vendi, ku treguesi i ujit pa të ardhura është në nivelin 65%, ky tregues për shoqërinë, në vlerën 54%, paraqitet nën këtë mesatare, por mbetet akoma në nivele të larta dhe duhet reduktuar.

f) Shoqëria me tarifat e reja të propozuara synon që në fund të vitit 2019 të dyfishojë performancën e mbulimit të kostove direkte të operim-mirëmbajtjes, duke e rritur atë deri në 67% nga 33% që është ajo aktuale, si edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, duke furnizuar mesatarisht popullsinë me 15 orë në ditë, nga 6 orë që është aktualisht.

g) Rritja e tarifave, për të mbuluar 100% kostot direkte të O&M, do të ishte një kërcim mjaft i madh dhe ndoshta me efekte të kundërta nga një reaksioni i mundshëm i konsumatorëve, sidomos i shtresave të popullsisë me të ardhura mesatare të ulëta.

6. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Vau i Dejës informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike-financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vau i Dejës, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;



c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes për të dyja shërbimet, pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që duhet të arrijnë të mbulojnë fillimisht këto kosto;

e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulëta;

f) ERRU-ja e konsideron të papranueshëm propozimin e operatorit për tarifën aforfe për shërbimin e kanalizimeve, për klientët jofamiljarë, pasi ata janë të pajisur me matës dhe aplikojnë tarifën volumetrike lekë/m³.

8. Komisioni Kombëtar Rregullator shqyrtoi dhe konsideroi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës nr. 558, datë 8.10.2018, “Mbi vlerësimin e projektvendimit të Entit Rregullator të Ujit, lidhur me aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës-Kanalizime Vau i Dejës”.

9. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- Shoqëria duhet të evidentojë asetet e kanalizimeve të ujërave të ndotura.

- Shoqëria duhet të punojë për legalizimin e lidhjeve të paligjshme.

- Shoqëria duhet të pajiset me matës të mëdhenj në burim dhe në rezervuare.

- Shoqëria duhet të ndërtojë një organigramë me përshkrimet përkatëse për çdo pozicion, si dhe të hartojë një program ku të parashikohet numri i duhur i punonjësve për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të KUN-së.

- Shoqëria duhet të hartojë planin e biznesit 5-vjeçar, i cili në aplikimin e ardhshëm të jetë i përditësuar.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se tarifat e propozuara janë të justifikuara ligjërisht, nuk janë abuzive dhe plotësojnë kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”, si edhe në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Vau Dejës, si më poshtë:

Kategoria	Për konsumatorët me matës		Për konsumatorët pa matës
	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse	Tarifa aforfe
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	Lekë/m³	Lekë/muaj	Lekë/muaj
1. Konsumator familjar	42	83	667
2. Konsumator publik	120	167	-
3. Konsumator privat	120	167	-
b) Për shërbimin e kanalizimeve	Lekë/m³	Lekë/muaj	Lekë/muaj
1. Konsumator familjar	7	-	83
2. Konsumator publik	20	-	
3. Konsumator privat	20	-	



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2019 të jenë:

Treguesit kryesorë të performancës	Njësia	TKP (viti 2017)	Objektivat e vlerësuara/ aprovuara nga ERRU-ja, viti 2019
Uji pa të ardhura	%	54%	45%
Mbulimi i kostove O&M	%	33%	67%
Mbulimi i kostove totale	%	20%	41%
Niveli i matjes	%	76%	91%
Vazhdimësia e FU-së	orë/ditë	6	15
Efikasiteti i stafit	staf/1000 lidhje	9	9
Mbulimi me ujë	%	26%	28%
Mbulimi me KUN	%	-	19%
Norma e arkëtimit	%	82%	92%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vau i Dejës sh.a. do të jetë 0,6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Vau i Dejës, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.12.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 75, datë 19.10.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBRAZHD, PËRRENJAS SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin

e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 19.10.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas (UK Librazhd, Përrenjas), me shkresën nr. 171 prot., datë 29.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për ndryshimin e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtjeje rrjeti të ujësjiellësit”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për miratimin e tarifave në të gjithë



zonën e shërbimit, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtjeje rrjeti të ujësjellësit të UK Librazhd, Përrenjas, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 57, datë 20.7.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Librazhd, Përrenjas, për nivelin e ri tarifor

për shërbimet UK, për të gjithë zonën e riorganizuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. UK Librazhd, Përrenjas, nëpërmjet shkresës nr. 171 prot., datë 29.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtjeje rrjeti të ujësjellësit”, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për ndryshimin e tarifave për zonën urbane dhe zonën rurale, sipas tabelës:

Kategoria	Tarifat volumetrike		Tarifa fikse shërbimi
	Zona urbane	Zona rurale	Zonat urbane dhe rurale
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	42	26	100
2. Konsumator publik	100	60	100
3. Konsumator privat	100	60	100
b) Për shërbimin e kanalizimeve	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	15	-	100
2. Konsumator publik	25	-	100
3. Konsumator privat	26	-	100

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Librazhd, Përrenjas, në vitin 2017 mbulon 88% të kostove totale, ndërkohë për arsye të zgjerimit të zonës në vitin 2018 (i pritshëm), ky tregues bie në masën 83%. Për vitin 2019, si rezultat i rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe përmirësimi i menaxhimit është parashikuar që mbulimi i kostove totale të jetë 102%.

b) Për vitin 2019 shoqëria ka propozuar një rritje të kostove me rreth 6% krahasuar me vitin 2018, ndërsa të ardhurat nga aktiviteti janë parashikuar të rriten me 30%, si rezultat i rritjes së treguesit të normës së faturimit, mbledhjes së borxheve dhe si rezultat i evidentimit të lidhjeve të paligjshme dhe legalizimit të tyre me kontrata.

c) Uji pa të ardhura parashikohet që në vitin 2019 të jetë në nivelin 71%, me pak ndryshim pozitiv krahasuar me vitin 2017, sepse sistemi i furnizimit me ujë nuk është me ngritje mekanike (me vetërrjedhje), por që, gjithsesi, është nivel i papranueshëm i këtij treguesi.

d) Niveli i matjes parashikohet të jetë 100% në vitin 2019 krahasuar me 96% që është aktualisht.

e) Kohëzgjatja mesatare e orëve të furnizimit me ujë është 24 orë në ditë për të gjitha zonat ku ekzistojnë sisteme inxhinierike të furnizimit me ujë.

f) Norma e arkëtimit parashikohet të përmirësohet me rreth 9% krahasuar me vitin 2017. Shoqëria raporton se ka një plan veprimi lidhur me eficiencën e mbledhjes së të ardhurave.

g) Nga 76.615 banorë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile përfitojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit rreth 18.752 banorë ose rreth 24% e popullsisë.

h) Shërbimi i largimit të ujërave të ndotura ofrohet vetëm në zonën urbane dhe përfitues janë 20% të popullsisë totale të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Viti 2019 është parashikuar me një rritje minimale prej 1%.

i) Treguesi i efikasitetit të stafit, për vitin 2019, parashikohet të përmirësohet dhe në mbyllje të vitit 2019 të jetë 4.68 punonjës për 1000 lidhje nga 6.34



që ishte në vitin 2017, përmirësim i cili do të vijë nga reduktimi i stafit që merret me aktivitetin e shoqërisë.

5. Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Librazhd, Përrenjas argumentohet, me:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit shoqëria aplikon për herë të parë, sipas metodologjisë, “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht, analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara dhe më pas përcaktimi i objektivave për treguesit e performancës.

b) Shoqëria përfshin në zonën e saj të shërbimit territorin administrativ të Bashkisë Përrenjas dhe të Bashkisë Librazhd, pas reformës administrative territoriale.

c) Shoqëria paraqitet mjaft problematike në drejtim të shtrirjes së shërbimeve UK. Mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë vetëm 82% e popullsisë së zonës urbane. Në zonën rurale vetëm 5% e popullsisë së regjistruar në juridiksion janë përfitues të furnizimit me ujë të pijshëm. Shërbimi i kanalizimeve ofrohet vetëm për zonën urbane. Rritja e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura paraqitet më se e domosdoshme, në mënyrë që gradualisht të arrihen të përmbushen nevojat për investime fizike, kryesisht për të mbuluar nevojat për zonat e pambuluara me shërbim.

6. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Librazhd, Përrenjas, informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike-financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Librazhd, Përrenjas, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji

nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Mbulimit të kostove totale për të dyja shërbimet, pasi, aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që duhet të arrijnë të mbulojnë këto kosto;

e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulëta.

8. Komisioni Kombëtar Rregullator shqyrtoi dhe konsideroi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës nr. 557, datë 8.10.2018, “Mbi vlerësimin e projektvendimit të Entit Rregullator të Ujit, lidhur me aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjellës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas”.

9. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- Shoqëria duhet të tregojë kujdes në hartimin e bilancit të ujit në drejtim të dhënies së argumenteve për secilin nënzë të humbjeve administrative dhe humbjeve fizike, si dhe që të dhënat e raportuara nga Departamenti i Klientëve të jenë të përputhshme me ato të bilancit të ujit nga dega teknike.

- Shoqëria ka një planbiznesi (2017–2021), por që nuk është i përditësuar me ndryshimet e ndodhura në kuadër të riorganizimit të shoqërisë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 dhe duhet të hartojë brenda vitit 2019, planin e biznesit 5-vjeçar për të gjithë zonën e shërbimit.

- Shoqëria duhet të hartojë një program për të ulur humbjet fizike, si dhe një plan kontrolli dhe disiplinimi të konsumatorëve abuzivë dhe lidhjeve të paligjshme.

- Shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura.

- Shoqëria duhet urgjentisht të përditësojë dhe të saktësojë *database* të klientëve, duke ndaluar së



faturuari klientët të cilët nuk ekzistojnë më, si dhe të hartojë një plan pune për të saktësuar shoqëritë që kanë ndërruar adresa ose janë larguar përfundimisht.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se tarifat e propozuara janë të justifikuara ligjërisht, nuk janë abuzive dhe plotësojnë kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si edhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat volumetrike		Tarifa fikse shërbimi
	Zona urbane	Zona rurale	Zonat urbane dhe rurale
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	42	26	100
2. Konsumator publik	100	60	100
3. Konsumator privat	100	60	100
b) Për shërbimin e kanalizimeve	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	15	-	100
2. Konsumator publik	25	-	100
3. Konsumator privat	26	-	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2019 të jenë:

Treguesit kryesorë të performancës	Njësia	TKP (viti 2017)	Objektivat e vlerësuar/ të aprovuara (viti 2019)
Uji pa të ardhura	%	75.5%	60%
Mbulimi i kostove O&M	%	108%	126%
Mbulimi i kostove totale	%	88%	102%
Niveli i matjes	%	96%	100%
Vazhdimësia e FU-së	orë/ditë	24	24
Efikasiteti i stafit	staf/1000 lidhje	6.34	4.68
Mbulimi me ujë	%	24%	25%
Mbulimi me KUN	%	20%	21%
Norma e arkëtimit	%	86%	95%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd Përrenjas sh.a. do të jetë 0,6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd, Përrenjas, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 4, datë 29.2.2012, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Librazhd, shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.12.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

**URDHËR****Nr. 566, datë 20.11.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Arben Dervishllari, drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.11.2018 deri në datën 23.11.2018.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Ardit Bido****KËRKESË****Nr. 9765/2, datë 14.11.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 599, datë 31.8.2016, ‘Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i rrugës ‘Dhimitër Konomi’, në zonën e Ujit të Ftohtë’, Vlorë’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni pronarin e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 490,635 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

**ZËVENDESMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**



TABELA PARAPRAKE E PRONARIT, PËR PASURINË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VKM-në NR. 599, DATË 31.8.2016, PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
 PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘NDËRTIMI I RRUGËS ‘DHIMITËR KONOMI’, NË ZONËN E UJIT TË FTOHTË’, VLORË”

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m²)	Sip. truall i prekur (m²)	Çmimi truall (lekë/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m²)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Fotaq Konomi, Nikollaq Konomi	Vlorë	Truall	8602	43/4/1	500	45	10,903	490,635				490,635	Konfirmuar nga ZVRPP-ja në datën 26.10.2018.
Vlera paraprake e shpronësimit							45	10,903	490,635		-	-	490,635	

**KËRKESË****Nr. 6596/6, datë 15.11.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i një Qendre Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara”, në fshatin Poshnjë, Bashkia Ura Vajguore.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajguore.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Beratit për vitin 2016, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 783,335 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDESMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

TABELA PARAPRAKE E PRONARËVE, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “NDËRTIMI I NJË QENDRE MULTIFUNKSIONALE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”, NË FSHATIN POSHNJË, BASHKIA URA VAJGUORE

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi i objektit	Vlera në lekë	Shënime sqaruese
1	Islam Halim Qemalaj	Ndërtesë (banimi)	3032	456/6+1-4	60	60	783335	783335	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale paraprake						60	783335		

Shënim. Vlerat e shpronësimit është llogaritur në bazë të kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e Entit të Banesave për qytetin e Beratit, për vitin 2016.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë